

VENDIM
Nr. 206, datë 21.3.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 98, DATË 9.2.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E KOMISIONIT SHTETËROR PËR NDIHMËN
JURIDIKE DHE ORGANIKËN E SEKRETARIATIT TË TIJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 6 të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lidhja nr. 2 “Organika e Sekretariatit të Komisionit Shtetëror për ndihmën juridike”, bashkëlidhur vendimit nr. 98, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha